



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT
DREJTORIA E VLERËSIMIT TË ANKESAVE

Nr.1828/9 Prot

Tiranë, më 25.11.2022

VENDIM

Nr.53, datë 25.11.2022

PËR

URDHËRIMIN E AUTORITETIT PUBLIK

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjës a) të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar,

KONSTATOVA SE:

Ankuesi, z. _____, ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Komisioneri”) Formularin e Ankesës nr. 1828 prot., datë 25.10.2022, me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare”, kundër Autoritetit Publik/Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit pranë Bashkisë Tiranë (në vijim “Autoriteti Publik”).

Ankuesi, në cilësinë e kërkuarit, nëpërmjet kërkesës së datës 07.10.2022, ka kërkuar t’i vihet në dispozicion informacioni/dokumentacioni, si më poshtë:

1. Sa ndërtime pa leje ka konstatuar IMT në territorin e Tiranës?
2. Për sa nga këto ndërtime pa leje janë marrë masa administrative për gjobitjen e ndërtuesit?
3. Për sa nga këto ndërtime janë kryer denoncime në Prokurori për shkelje të Kodit Penal? Sa subjekte janë marrë si të pandehur?
4. Sa nga këto ndërtime janë demoluar?
5. Cilat janë masat më të shpeshta ndaj këtyre subjekteve?
6. Sa punonjës (inspektorë në terren) ka bashkia Tiranë?
7. Sa është numri total i policëve bashkiak të punësuar nga Bashkia Tiranë?

Autoriteti Publik, nëpërmjet koordinatores për të drejtën e informimit, me e-mail-in datë 27.10.2022 i ka kthyer përgjigje kërkuarit duke e njoftuar se kërkesa është protokolluar pranë Bashkisë Tiranë me nr. prot. R-23190, dhe i ka vendosur në dispozicion informacionin për pikën 7 të kërkesës.

Ankuesi, pas përgjigjes së Autoritetit Publik, dhënë me e-mail-in e datës 27.10.2022, pretendon se i është kthyer përgjigje vëtëm për një nga shtatë pikat e kërkesës për informacion. Ndodhur në këto kushte, me pretendimin se është cënuar në të drejtën për informim, i është drejtuar Zyrës së Komisionerit për të vijuar ankesën e tij, nr 1828 prot., datë 25.10.2022, duke i kërkuar ushtrimin e kompetencave që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit, për pikat 1, 2, 3, 4, 5 dhe 6 të kërkesës për informacion, me anë të e-mail-it, të datës 28.10.2022.

Komisioneri pas shqyrtimit paraprak të ankesës, bazës ligjore dhe rrethanave të faktit të paraqitura në të, vlerësoi se ankesa përmbush kriteret formale ligjore, të përcaktuara në nenin 24 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” (në vijim “LDI”).

Në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, si hap paraprak përpara marrjes së vendimit, në përputhje me nenin 10 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i cili parashikon: “*Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjëndje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur*”, Zyra e Komisionerit, me shkresën nr. 1828/1 prot., datë 28.10.2022, ka kërkuar qëndrimin e Autoritetit Publik, në lidhje me pretendimin e ngritur nga ankuesi, si dhe sqarime në lidhje me disponimin e dokumentacionit të kërkuar.

Me qëllim verifikimin e fakteve dhe rrethanave, që mund të jenë bërë pengesë për vënien në dispozicion të informacionit të kërkuar, si dhe evidentimin e personave përgjegjës të caktuar për trajtimin e kërkesës për informacion, si hap paraprak përpara marrjes së vendimit, në përputhje me nenin 15, 18, 24 të ligjit nr. 119/2014, “Për të Drejtën e Informimit” dhe 31/1/c të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar, Zyra e Komisionerit ka nxjerr Urdhrin nr. 200, datë 14.11.2022, për kryerjen e inspektimit administrativ, për verifikimin e ankesës së depozituar pranë Zyrës së Komisionerit nr. 1828 prot., datë 25.10.2022, nga z. _____, me objekt refuzimin e dhënies së informacionit dhe kopje të dokumenteve zyrtare, me qëllim verifikimin e fakteve dhe rrethanave, që mund të jenë bërë pengesë për vënien në dispozicion të informacionit të kërkuar, si dhe evidentimin e personave përgjegjës të caktuar për trajtimin e kërkesës për informacion.

Në vijim të inspektimit të kryer nga Zyra e Komisionerit, autoriteti publik, ka kthyer përgjigje me anë të shkresës, protokolluar pranë Bashkisë Tiranë, me nr. prot. 8985/1, datë 16.11.2022, duke informuar ankuesin, ndër të tjera, se:

“...në lidhje me statistikën se sa kallëzime penale janë bërë për ndërtimet pa leje, mund t'i drejtoheni organit të Prokurorisë, si organi kompetent për hetimin e ndërtimeve pa leje e parashikuar si vepër penale konform nenit 199/a të Kodit Penal...”

Pas përgjigjes së sipërcituar, ankuesi ka vijuar ankimin, të regjistruar pranë Zyrës së Komisionerit me nr. 1828/5 prot., datë 14.11.2022, duke rikonfirmuar qëndrimin e reflektuar në ankesë.

Pas konsultimit të legjislacionit përkatës dhe dokumentacionit të administruar gjatë hetimit administrativ, Komisioneri vlerëson se, qëndrimi i Autoritetit Publik nuk është në përputhje me dispozitat e LDI, si dhe detyrimet që burojnë nga ky i fundit.

Bazuar në shkronjën “a” të pikës 1 të nenit 2 të LDI parashikohet se: *“Autoritet publik” është çdo organ administrativ i parashikuar në legjislacionin në fuqi për procedurat administrative, organet ligjvënëse, gjyqësore dhe ato të prokurorisë së çdo niveli, organet e njësisve të qeverisjes vendore të çdo niveli, organet shtetërore dhe entet publike, të krijuara me Kushtetutë ose me ligj”*.

Në kuptim të këtij parashikimi, Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit pranë Bashkisë Tiranë është Autoritet Publik dhe subjekt i LDI, për rrjedhojë detyrohet për zbatimin e tij, duke garantuar njohjen e publikut me informacion në kuadër të transparencës.

Për të mundësuar realizimin e objektit dhe qëllimit të tij, LDI, në pikën 1 të nenit 1 përcakton se: *“1. Ky ligj rregullon të drejtën e njohjes me informacionin që prodhohet ose mbahet nga autoritetet publike. Në këtë kuptim, çdo autoritet publik pavarësisht nëse është në cilësinë e “prodhuesit” apo “mbajtësit” të informacionit, detyrohet të garantojë njohjen e publikut me informacion, në kuadër të ushtrimit të të drejtave dhe lirive të individit në praktikë, si dhe të formimit të pikëpamjeve për gjendjen e shtetit dhe të shoqërisë.*

Refuzimi i dhënies së informacionit me pretendimin e Autoritetit Publik, se është informacion i kufizuar sipas parashikimeve të nenit 17, pika 2/b të ligjit 119/2014, “Për të Drejtën e Informimit” në të cilën parashikohet se : *“E drejta e informimit kufizohet në rast se është e domosdoshme, proporcionale dhe nëse dhënia e informacionit shkakton një dëm të qartë dhe të rëndë ndaj interesave të mëposhtëm: b) parandalimin, hetimin dhe ndjekjen e veprave penale”*.

Parashikimi i mësipërm, nuk qëndron pasi ankuesi, z. _____, ka kërkuar informacion statistikor, i cili nuk përfshihet në kufizimet e nenit 17 të ligjit të sipercituar, dhe në çdo rast, Autoriteti Publik, për vënien në dispozicion të informacionit/dokumentacionit të kërkuar, duhet të mbajë në konsideratë parashikimet e pikës 6 të nenit 17 të LDI, ku përcaktohet se: *“Nëse kufizimi prek vetëm një pjesë të informacionit të kërkuar, pjesa tjetër nuk i refuzohet kërkuetit. Autoriteti Publik tregon qartë pjesët e dokumentacionit përkatës që janë refuzuar, si dhe në bazë të cilës pikë të këtij neni është bërë ky refuzim”*.

Për sa më sipër, informacioni i kërkuar përmbush kërkesat e pikës 2, të nenit 2, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, sipas të cilit *“informacion publik” konsiderohet çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga Autoriteti Publik”*. Rrjedhimisht, ekzistenca e informacionit/dokumentacionit të mësipërm pavarësisht nëse ai është i prodhuar apo administrohet nga Autoriteti Publik, ngarkon me përgjegjësi këtë të fundit, për vënien në dispozicion të informacionit të kërkuar.

Si përfundim, Komisioneri thekson se, LDI ka për qëllim të nxisë përforcimin e integritetit, të transparencës e të përgjegjshmërisë së Autoriteteve Publike dhe çdo subjekti tjetër jo shtetëror, që ushtron funksione publike.

Për sa më sipër, bazuar në pikën 3, të nenit 3 të LDI, “Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentacionit”.

Në lidhje me trajtimin e praktikës, nga verifikimi i dokumentacionit bashkëlidhur, si dhe inspektimit të kryer pranë Autoritetit Publik/Inspektoriati i Mbrojtjes së Territorit pranë Bashkisë Tiranë, konstatohet se personi që ka trajtuar kërkesën për informacion dhe ka nënshkruar kthim përgjigjen nr. 8985/1 prot., datë 16.11.2022, është Kryeinspektori.

Gjatë inspektimit të kryer, z. Mariglen Qato, rikonfirmoi qëndrimin e mbajtur në shkresën e protokolluar pranë Bashkisë Tiranë, me nr. prot. 8985/1, datë 16.11.2022, duke marrë dhe përgjegjësinë e trajtimit të praktikës.

Bazuar në nenin 18, pika 2 a) e ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, refuzimi për dhënien e informacionit përbën shkelje administrative, e cila dënohet me gjobë, që varion nga 150.000 (njëqind e pesëdhjetë mijë) Lekë deri në 300.000 (treqind mijë) Lekë.

E drejta për informim është një prej të drejtave themelore të njeriut, e parashikuar në nenin 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Kjo e drejtë duhet parë e lidhur ngushtë me parimin e transparencës dhe llogaridhënies, si një shtyllë tjetër themelore e shtetit të së drejtës. Funksionimi i tyre do të ishte në interesin e të dy palëve.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në shkronjën a) të pikës 2 të nenit 18, pikën 3 të nenit 18, pikën 2 dhe 3 të nenit 19, pikat 1 dhe 2 të nenit 21, nenin 22, shkronjat b) dhe ç) të pikës 5 të nenit 24 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, ligjin nr.10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar,

V E N D O S A:

1. Pranimin e ankesës nr. 1828 prot., datë 25.10.2022, nga z. _____, kundër Autoritetit Publik, “Inspektoriati i Mbrojtjes së Territorit pranë Bashkisë Tiranë”, me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare”.
2. Urdhërimin e Autoritetit Publik, për vënien në dispozicion të informacionit/dokumentacionit sipas kërkesës për informacion datë 07.10.2022, për pikat të cilat Autoriteti Publik nuk ka kthyer përgjigje, konkretisht:
 - Sa ndërtime pa leje ka konstatuar IMT në territorin e Tiranës?
 - Për sa nga këto ndërtime pa leje janë marrë masa administrative për gjobitjen e ndërtuesit?
 - Për sa nga këto ndërtime janë kryer denoncime në Prokurori për shkelje të Kodit Penal? Sa subjekte janë marrë si të pandehur?
 - Sa nga këto ndërtime janë demoluar?
 - Cilat janë masat më të shpeshta ndaj këtyre subjekteve?
 - Sa punonjës (inspektorë në terren) ka bashkia Tiranë?,

- brenda datës 09.12.2022.
3. Dënimin e z. Mariglen Qato, në cilësinë e personit përgjegjës, me gjobë në vlerën 150.000 (njëqind e pesëdhjetë mijë) lekë, në përputhje me nenin 19, pika 2 dhe 3 e ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”. Masa e dënimit me gjobë, shlyhet me këste mujore. Gjoha ekzekutohet nga zyra e financës së Autoritetit Publik brenda 6 muajve nga data e njoftimit të vendimit.
 4. Kundër vendimmarrjes në pikat 1 dhe 2, palët kanë të drejtën e ankimit brenda 45 ditëve në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, në përputhje me nenin 25 të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”.
 5. Kundër vendimmarrjes në pikën 3, personi ndaj të cilit është vendosur sanksioni administrativ, ka të drejtën e ankimit brenda 30 ditëve kalendarike nga data e marrjes së njoftimit të vendimit në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, në përputhje me nenin 22 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.
 6. Ky vendim u shpall sot në datë 25.11.2022.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi